



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA FIER  
NDËRMARRJA E SHËRBIMEVE PUBLIKE FIER

Nr. \_\_\_\_/\_\_\_\_Prot.

Fier, më 20.04.2023

**Lënda:** Formulari i njoftimit perfundimtar të fituesit pas ankimit për procedurën me objekt “**Sherbim sinjalistike horizontale për rruget e Bashkisë Fier**”, (Marreveshje Kuader me një operator ekonomik fitues, ku të gjitha kushtet janë të percaktuara, me afat 24 muaj), me burim financimi nga Buxheti i Ndermarrjes së Sherbimeve Publike Fier.

AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK  
TIRANË  
(për botim)

Shtojca 14

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË  
MARRËVESHJEN KUADËR (NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

NDËRMARRJA E SHËRBIMEVE PUBLIKE FIER

**Data:** 20.04.2023

**Drejtuar:** Operatorit ekonomik I.D.K-KONSTRUKSION SHPK

**Adresa** Tirane Vore VORE Autostrada Tirane-Durres, Km.12, Rruga Zaja, Koder Bexulle, Nr.Pasurie  
1014/3, ZK.1167

NUIS K51408016J

**\* \* \***

Procedura e prokurimit: : “**Procedurë e hapur e thjeshtuar me mjete elektronike**” (Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të percaktuara - me afat 24 muaj).

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-63124-03-21-2023**

**Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Sherbim sinjalistike horizontale per rruget e Bashkise Fier”, me fond limit/vlera e pritshme e kontratave prej 10 000 000 (dhjete milion) lekë pa TVSH, me burim financimi nga Buxheti i Ndermarrjes se Sherbimeve Publike Fier, në perputhje me preventivat, sasitë, specifikimet teknike, termat e referencës dhe kushtet e përcaktuara në DST.**

Afati kohor për ekzekutimin e kontratës: **24 (njetete e kater) muaj nga nënshkrimi i marrëveshjes kuadër.**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [27.03.2023.], [Numri 28].

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim **PO**

Me anë të këtij Njoftimi bëjmë me dije se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë me vlerat përkatëse si më poshtë:

1. Operatori ekonomik I.D.K-KONSTRUKSION SHPK me NUIS K51408016J.Vlera totale sipas shtojcës 2 ”Lista e çmimeve sipas zërave të preventivit”është 9 693 391,26 (nëntë milion e gjashtë qind e nëntëdhjetë e tre mijë e tre qind e nëntëdhjetë e një pikë njëzet e gjashtë) lekë pa TVSH.
2. Operatorie konomikSI.SI-AL sh.p.k me NUIS K72117030P. Vlera totale sipas shtojcës 2 ”Lista e çmimeve sipas zërave të preventivit” është 8 503 726.15 (tetë milion e pesëqind e tre mijë e shtatëqind e njëzet e gjashtë pikë pesëmbëdhjetë ) lekë pa TVSH.

Eshte skualifikuar Operatori ekonomikë i mëposhtëm:

Operatori ekonomik SI,SI-AL sh.p.k. skualifikohet për arsye se:

1. Referuar Shtojcës 8 të DST-së, pika 2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, nuk është përmbushur pika 1/a, ku përcaktohet:

❖ “Ofertuesi duhet të paraqesë:

a) Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9”

❖ Nga ana e operatorit ekonomik SI.SI-AL sh.p.k., nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në SPE, rezulton të mos jetë paraqitur Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, në përmbushje të pikës 1/a, si më sipër, pra mungon Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9.

2. Referuar Shtojcës 8 të DST-së, pika 2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3 “Kapaciteti teknik”, nuk është përmbushur pika 2.3.2 “Stafi kryesor e mbështetës, punonjësit, çertifikimet, i kualifikuar”, ku përcaktohet:

“Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij si drejtues teknik të shoqërisë, inxhinierin e mëposhtëm:

**I. Inxhinier ndërtimi/Infrastruktura 1 (një).**

Inxhinieri i mësipërm duhet të figuroj si drejtues teknik në licensën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listëpagesat e shoqërisë për të paktën periudhën **Shkurt 2023**. Për inxhinierin duhet të paraqitet: Diploma, Kontratë individuale pune (e vlefshme).

b) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij **ose** me kontratë pune të vlefshme për periudhën e realizimit të kontratës personel të kualifikuar/çertifikuar si më poshtë:

- 1 (një) punonjës përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë, I cili të jetë I çertifikuar **“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”** në përputhje me klauzolat e ligjit nr.10327, datë 18.02.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010, “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”.

c) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij **ose** me kontratë pune të vlefshme për periudhën e realizimit të kontratës specialistë të çertifikuar sipas profesioneve, të paktën si më poshtë:

➤ **Manovrator 2 (dy)**

Për specialistët e sipërcituar duhet të paraqiten dëshmi/certifikatë ose cdo dokument tjetër që vërteton diplomimin apo kualifikimin e tyre, si dhe kontratë individuale të punës e vlefshme për të paktën periudhën e parashikuar të zbatimit të kontratës.

**Shënim:** Përpikat **a)**, **b)** dhe **c)** më sipër, operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesi në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.9.

*Ndërsa operatori ekonomik I kualifikuar I pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sic kërkohet në shkronjat **a)**, **b)** dhe **c)** të pikes 2.3.2, si më sipër kërkuar. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin.”*

Operatori tekonomik SI.SI-ALsh.p.k., në përmbushje të këtij kriteri, ka paraqitur në SPE:

- Për Inxhinier ndërtimi/Infrastruktura 1 (një) është paraitur diplomë nr.1351, datë 29.06.1991, në emër të Znj. I.T dhe kontratë pune nr. 912 kol., nr.291 kol. datë 06.03.2021, në emër të Znj. I.K(I.T).
- Për 1 (një) punonjës përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë, I cili të jetë I çertifikuar **“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”** është paraqitur çertifikatë “Person përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë”, date 06.09.2022, në emër të Z.A.A.
- Për manovrator 2 (dy), nuk është paraqitur asnjë dokumentacion.

Sa më sipër, në kushtet kur nga OE SI.SI-ALsh.p.k., nuk është paraqitur Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST-së dhe dokumentacioni i paraqitur në SPE për përmbushjen e pikës 2.3.2, nuk është i plotë, KVO vlerëson se mungesa e dokumentacionit si më sipër sqaruar përbën shkak skualifikimi dhe mospërmbushje të pikës 2.3.2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”.

- Referuar Shtojcës 8 të DST-së, pika 2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3 “Kapaciteti teknik”, nuk është përmbushur pika 2.3.3, ku përcaktohet:

“Operatori Ekonomik Ofertues duhet të ketë fuqi minimale punetore të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, me një numër prej jo më pak se 5 (pesë) punonjës, për muajin Shkurt 2023.”

**Shënim:** Përpikën 2.3.3 më sipër, operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.9.

Ndërsa operatori ekonomik I kualifikuar I pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, siç kërkohet në pikën 2.3.3, duke dorëzuar dokumentacionin origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve, për muajin Shkurt 2023.
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për muajin Shkurt 2023.”

Sa më sipër, në kushtet kur nga OE SI.SI-ALsh.p.k., nuk është paraqitur Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST-së, si dhe kur në SPE nuk është paraqitur asnjë nga dokumentat e poshtëshënuar për përmbushjen e pikës 2.3.3:

-Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve, për muajin Shkurt 2023.

- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për muajin Shkurt 2023.”

KVO vlerëson se përbën shkak skualifikimi dhe mospërmbushje të pikës 2.3.3 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”.

- Referuar Shtojcës 8 të DST-së, pika 2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3 “Kapaciteti teknik”, nuk është përmbushur pika 2.3.5, ku përcaktohet:

“Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë çertifikatë të menaxhimit të cilësisë ISO 9001-2015 ose kuivalente e saj për objektin që prokurohet (e cila duhet të jetë e përkthyer në shqip dhe e noterizuar) e lëshuar nga Organizmat e Vlerësimit të Konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga Organizmat Ndërkombëtare Akreditues të njohura në Republikën e Shqipërisë.”

Nga verifikimi i dokumentacionit të hedhur në SPE nga OE SI.SI-AL sh.p.k. në përmbushje të këtij kriteri, KVO konstatoi se ISO 9001-2015, lëshuar nga CERTI W Baltic Ltd, nr.çertifikate SB.13.0388.01.QMS,

ka si date skadence datën 12.03.2023, pra jashtë afatit të vlefshmërisë ligjore, duke marrë në konsideratë edhe faktin se kjo procedure prokurimi publikë është publikuar në SPE më datë 23.03.2023.

5. Referuar Shtojcës 8 të DST-së, pika 2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3 “Kapaciteti teknik”, nuk është përmbushur gërma “a” dhe ”b” e pikës 2.3.7, ku përcaktohet:

”Operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion:

- a)** “Mjetet, makineritë dhe pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, si më poshtë (sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.9):

<b>Nr.</b>	<b>Mjetet</b>	<b>Sasia (copë)</b>	<b>Statusi</b>
1.	Mjet transporti jo me pak se 1,5ton(me vinc)	1 (një)	Në pronësi ose me qera
2.	Semafor per menaxhim trafiku	1 (një)	Në pronësi ose me qera
3.	Kone plastike	25(njezet e pese)	Në pronësi ose me qera
4.	Pajisje per matje retroreflektivitetit te bojës se vijeimit rrugor	1 (një)	Në pronësi ose me qera
5.	Makineri vijeimi per bojë bikomponente sprajt	1 (një)	Në pronësi ose me qera
6.	Automjet vijeimi (APF) me boje termoplastike (sprajit)	1 (një)	Në pronësi ose me qera

- b)** Operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion pajisjet teknike (pronësi ose me qera), të nevojshme për ekzekutimin e kontratës si më poshtë (sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.9):

- Kokore, minimum 5 copë.
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila, minimumi 2 copë.
- Komplet i ndihmës së shpejtë, minimumi 2 copë.
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në object minimumi, 4 copë.
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 4 (katër) copë

**Shënim:** Për pikën 2.3.7 (a dhe b) si më sipër, operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin deklaratë sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.9.“

Sa më sipër, në kushtet kur nga OE S.I.SI-AL sh.p.k., nuk është paraqitur Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST-së, si dhe kur në SPE nuk është hedhur asnjë dokumentacion i nevojshëm në lidhje me:

- mjetet, makineritë dhe pajisjet teknike te nevojshme per ekzekutimin e kontrates;
- pajisjet teknike (pronësi ose me qera), të nevojshme për ekzekutimin e kontratës,

KVO vlerëson se përbën shkak skualifikimi dhe mospërbushje të pikes 2.3.7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “I.D.K-KONSTRUKSION SHPK, me adrese “Tirane Vore VORE Autostrada Tirane-Durres, Km.12, Rruga Zaja, Koder Berxulle, Nr.Pasurie 1014/3, ZK.1167”, numri i NUIS K51408016J, , se oferta e paraqitur me një vlerë totale 9 693 391,26 (*nëntë milion e gjashtë qind e nëntëdhjetë e tre mijë e tre qind e nëntëdhjetë e një pikë njëzet e gjashtë*) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë autoritetit kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike , Fier, **Lagja “11 Janari”, Rruga “Ramiz Aranitasi”**, per te nenshkruar marreveshjen kuader brenda 10 (dhjete) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk paraqiteni brenda afatit përfundimtar ose tërhiqeni nga nënshkrimi i marreveshjes kuader, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe marreveshja do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraparak)

PO  JO

**Nuk ka patur ankesa**

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

\_\_\_\_\_  
**Ludovik Taraj**